


Aksidentet Rrugore

Shkurt 2022

Tiranë, më 18 Mars 2022 : Në muajin Shkurt 2022 numërohen 77 aksidente rrugore nga 79 aksidente të ndodhura në muajin Shkurt 2021, duke u ulur me 2.5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në dymujorin e parë të vitit 2022 numërohen 184 aksidente rrugore nga 204 aksidente, të ndodhura në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke u ulur me 9,8 %.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Shkurt 2018 – Shkurt 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Shkurt 2022, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 100 persona nga 103 që ishte në të njëjtën muaj të një viti më parë. Në dymujorin e parë të vitit 2022, numri i të aksidentuarve është 247 persona nga 268 persona të aksidentuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Shkurt 2022, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 16 persona, nga 18 persona të vdekur në Shkurt 2021. Në dymujorin e parë të vitit 2022, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 32 persona nga 40 persona të vdekur në dymujorin e parë të vitit 2021.

Në muajin Shkurt 2022, aksidentet rrugore, në 88,3 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 35 - 44 vjeç, duke zënë 23,4 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë rritur me 50,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në dymujorin e parë të vitit 2022, aksidentet rrugore, në 11,7 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur me 27,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore dhe numri i të aksidentuarve sipas gjinisë

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Shkurt 2021	79	4	14	20	65	
Shkurt 2022	77	2	14	28	56	
Ndryshimi vjetor (%)	-2,5	-50,0	0,0	40,0	-13,8	
Janar-Shkurt 2021	204	8	32	65	163	
Janar-Shkurt 2022	184	5	27	63	152	
Ndryshimi vjetor progresiv %	-9,8	-37,5	-15,6	-3,1	-6,7	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidentet sipas			
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Shkurt 2021	64	15	13	5
Shkurt 2022	68	9	14	2
Ndryshimi vjetor (%)	6,3	-40,0	7,7	-60,0
Janar-Shkurt 2021	164	40	34	6
Janar-Shkurt 2022	155	29	27	5
Ndryshimi vjetor progresiv %	-5,5	-27,5	-20,6	-16,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periodha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Shkurt 2021	21	25	12	12	6	3
Shkurt 2022	16	15	18	13	10	5
Ndryshimi vjetor (%)	-23,8	-40,0	50,0	8,3	66,7	66,7
Janar-Shkurt 2021	49	60	40	24	17	14
Janar-Shkurt 2022	35	46	37	35	19	12
Ndryshimi vjetor progresiv %	-28,6	-23,3	-7,5	45,8	11,8	-14,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rrugore dhe numri i të vdekurve sipas qarqeve

Periodha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Shkurt 2021	Shkurt 2022	Shkurt 2021	Shkurt 2022	Janar-Shkurt 2021	Janar-Shkurt 2022	Janar-Shkurt 2021	Janar-Shkurt 2022
Shqipëria	79	77	18	16	204	184	40	32
Berat	2	2	0	1	5	6	0	1
Dibër	0	1	0	1	2	2	0	2
Durrës	5	5	3	3	18	12	5	5
Elbasan	8	2	3	3	15	5	4	5
Fier	8	6	2	4	14	13	6	7
Gjirokastrë	1	5	0	0	8	9	1	0
Korçë	3	3	0	1	8	7	2	1
Kukës	5	1	1	0	9	10	1	2
Lezhë	8	8	1	1	23	21	7	3
Shkodër	0	2	0	1	3	5	2	3
Tiranë	36	39	5	0	92	88	6	2
Vlorë	3	3	3	1	7	6	6	1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet.

I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- pa vlerë
- (...) mungesë të dhënash